



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 7 shtator 2023

Në mbështetje të nenit 13 (Këshilltarët Juridik) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të rregullit 22 (Njësia Ligjore e Gjykatës Kushtetuese) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023; si dhe në mbështetje të neneve 2, 6, 7 dhe 12 të Rregullores Nr. 03/2019 të Njesisë Ligjore, Sekretaria shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

1.

Pozita: Këshilltar Kushtetues Juridikë
Kodi: GJ-NJL 02-09
Numri i vendeve të punës: 3 (tre)
Kohëzgjatja e kontratës: Pa afat
Puna Provuere: 1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës

Nën mbikëqyrje të Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik dhe nën drejtimin e Kryetarit/es dhe gjyqtarëve përkatës, mbështet punën profesionale të gjyqtarëve duke bërë hulumtime dhe analiza ligjore si dhe duke ndihmuar në hartimin e raporteve paraprake, vendimeve si dhe materialit tjetër ligjor në mbështetje të punës së gjyqtarëve të Gjykatës dhe detyra të tjera relevante të caktuara.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Mbështetë punën e Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridikë;
- Hulumton dhe studion literaturë përkatëse kushtetuese –ligjore të nivelit vendor dhe ndërkombëtar;
- Hulumton dhe kërkon informacion të nevojshëm, *inter alia*, të vendimeve të gjykatave të tjera kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Përgatitë analiza krahasuese në bashkërendim me Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë;
- Kontribuon në funksionimin efektiv dhe efikas të Njesisë Ligjore si dhe kryen punë tjera që kërkohen nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme

- Përgatitja universitare në shkencat juridike, preferohet ekspertizë në të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, të drejtësisë kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut;
- tri (3) vite përvojë profesionale juridike;
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Po ashtu, kandidati duhet të demonstrojë qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve adekuata me burime të kufizuara, të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me shkrim), të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet, të ketë aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, dhe hulumtimit në internet.

Informata të përgjithshme për kandidatët

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe e të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procedurës së rekrutimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në receptionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës si dhe shpalljes publike duke filluar nga data 7/09/2023 deri më datën 21/09/2023, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 21/09/2023, deri në ora 16.00.

Shënim:

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.